# Ushtarët realizojnë ëndrrën e personave me Distrofi Muskulore






***"Për ta realizuar ëndrrën tonë, shënimin e 'Javës së Distrofisë', na duhej FSK-ja. Pa këtë forcë ne kurrë nuk do ta arrinim ta realizonim këtë aktivitet. Qëllimi ynë ishte që këtë ditë ta shënojmë më ndryshe; vizitën në Kalanë e qytetit ta bënim këmbë, kjo ishte edhe ëndrra, jo vetëm e imja, por e të gjithë këtyre personave. Kjo ëndërr ishte e parealizueshme për ne. Kurrë nuk do ta realizonim atë po mos të ishte FSK-ja, ushtarët tanë, të cilët na ndihmuan në realizimin e saj", ishin fjalët e kryetares së OPDMK-së, Antigona Shestan, me përkatësi kroate***

PRIZREN, 28 MAJ - Organizata e Personave me Distrofi Muskulore të Kosovës (OPDMK) në qytetin e bukur të Prizrenit ka shënuar "Javën e Distrofisë Muskulore", me moton: "Sfida dhe dëshira". Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë mbi pesëdhjetë veta të prekur nga kjo sëmundje. Shënimin e "Javës së Distrofisë" kësaj organizate ia kanë mundësuar Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Polica e Kosovës (PK). Po ashtu, kanë ndihmuar edhe pjesëtarë të KFOR-it, NAT-it, OSBE-së, Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës, CARITAS-it, DOKUFT-it, etj. "Për ta realizuar ëndrrën tonë, shënimin e 'Javës së Distrofisë', na duhej FSK-ja. Pa këtë forcë ne kurrë nuk do ta arrinim ta realizonim këtë aktivitet. Qëllimi ynë ishte që këtë ditë ta shënojmë më ndryshe; vizitën në Kalanë e qytetit ta bënim këmbë, kjo ishte edhe ëndrra, jo vetëm e imja, por e të gjithë këtyre personave. Kjo ëndërr ishte e parealizueshme për ne. Kurrë nuk do ta realizonim atë po mos të ishte FSK-ja, ushtarët tanë, të cilët na ndihmuan në realizimin e saj. Forca jonë na e bëri të lehtë, na e bëri të mundshme dhe të realizueshme këtë ëndërr. E falënderoj mijëra herë nga zemra!", ishin fjalët e kryetares së OPDMK-së, Antigona Shestan, me përkatësi kroate.

Ajo pareshtur ka falënderuar ushtarët e Kosovës dhe nënkolonel Enver Dugollin, i cili nëpërmjet Departamentit Civilo-Ushtarak të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës kishte ndihmuar shumë në realizimin e këtij aktiviteti me rëndësi të madhe për organizatën dhe personat me Distrofi Muskulore të Kosovës.

Pasi arritën ta "pushtonin" kalanë, kryetarja Shestan është shprehur: "Ne kërkuam forca dhe forca jonë na erdhi. Mu ka dashtë një forcë e madhe për ta realizuar këtë aktivitet, e ajo që ku është. Pa FSK-në kurrë nuk do të kishim ardhur këtu. Kjo është forca jonë, shumë, shumë u jam falënderues. Forca që kishim kërkuar, erdhi, dhe falë saj ne e bëmë të pamundurën të mundshme. Ne shumë herë kemi planifikuar ta vizitojmë Kalanë e Prizrenit, jo me automjete, por në një mënyrë krejt tjetër; këmbë, me karroca, për ta shënuar 'Javën e Personave me Distrofi Muskulore'. Ne menduam të bëjmë diçka të mirë për këta persona, që edhe ata ta ndiejnë veten më afër të tjerëve, më afër shoqërisë; që edhe ne të besojmë se shoqëria jonë është me ne, është afër neve. Kjo ëndërr më në fund u realizua falë FSK-së", ka theksuar ajo, duke shtuar se "nënkolonel Dugolli dhe ushtarët tanë në çdo çast ishin me ne, na dhanë forcë dhe besim në vete, që sot ta shijojmë ajrin e pastër të Bistricës, të Kalasë sonë, të Prizrenit tonë".

Të gjithë personat e ndienin veten shumë të relaksuar dhe të gjithë kanë shprehur falënderime për ushtarët e FSK-së, të cilët i ndihmuan duke i bartur në krahë me karroca dore. "Shpirtërisht po bindem se shoqëria jonë është me ne", ka thënë në fund kryetarja Shestan.

Ndërkaq nënkolonel Enver Dugolli është shprehur se FSK-ja gjithmonë është pranë të gjithë qytetarëve të Kosovës, pranë të gjitha kategorive, pa dallime gjinie, race dhe feje për t'u dalë në ndihmë. "Edhe sot, kur jemi së bashku me personat me distrofi muskulore, për këtë, po e ndiej veten shumë të relaksuar, sepse shoqëria jonë duhet ta ndihmojë edhe këtë kategori të qytetarëve tanë, që ata mos ta ndiejnë veten se shoqëria po i lë anash. Ne gjithmonë do t'u dalim në ndihmë qytetarëve që e kërkojnë ndihmën tonë", ka deklaruar nënkolonel Dugolli.

Ndërsa një vajzë e re, e cila ka mbetur në karrocë si pasojë e sëmundjes së distrofisë muskulore, ka thënë se për herë të parë po e vizitonte Kalanë. "Ndihem shumë e lumtur që e vizitova Kalanë. Këtë ma mundësoi FSK-ja. E falënderoj nga zemra", ka theksuar ajo.

Pas vizitës dhe qëndrimit disaorësh në Kala, prapë me ndihmën e ushtarëve të FSK-së ata janë kthyer në Sheshin e Shatërvanit, aty ku e filluan garën në maratonë. Simbolikë e shënimit të "Javës së Distrofisë Muskulore" ishte bartja me vete e qindra balonave të bardhë. Në fund të gjithë personat me Distrofi Muskulore kanë bërë fotografi të përbashkët me ushtarët e FSK-së.